



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 22.10.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çausi, Albulena Balaj-Halimaj, Abdyl Salihu, Arbërie Nagavci dhe Mufera Shinik.

Munguan: Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj dhe Verica Çeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Myzafere Limani, Arsim Bajrami e Lindita Pula nga ASHAK, përfaqësues të KDI dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim i komisionit me anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takim i komisionit me anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka vendosur që të ketë një takim me anëtarët e Akademisë me qëllim të njohjes me punët dhe aktivitetet e Akademisë.

Myzafere Limani, sekretare shkencore e Akademisë, tha se Akademia si institucion me i lartë i shkencës në vend është themeluar në vitin 1975. Ajo foli për punën, funksionimin, veprimtarinë dhe dinamikën e punës në këtë institucion, sidomos pas miratimit të ligjit për Akademinë në janar të vitin 2016. Ajo tha se me ligjin e miratuar janë marrë për bazë dy kërkesat kyçe të ALEA – Bashkësia e Akademive Nacionale të Evropës e që kanë të bëjnë me uljen e moshës mesatare në Akademi dhe përbërjen gjinore. Po ashtu tha Akademia i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit me akademitë në rajon si në nivel të bashkëpunimit e korrespondencave që kemi. Kujdes të veçantë i kushtojmë edhe organizimit dhe pjesëmarrjes në konferenca. Ajo po ashtu foli edhe për planin strategjik 2018-2021 të Akademisë si një dokument bazë për punën e saj, nga i cili dokument dalin plani vjetor i punës dhe projekte të tjera të Akademisë.

Arsim Bajrami foli për strukturën organizative, si dhe veprimtarinë e Akademisë. Tha se në përbërjen e vetë Akademia ka gjithsejtë 38 anëtarë të rregullt, korrespondent dhe të jashtëm. Organet e Akademisë janë Kuvendi, Kryesia dhe kryetari. Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar ai tha se Akademia ka arritur të anëtarësohet në dhjetëra organizata ndërkombëtare dhe ka një bashkëpunimi shumë të mirë me to. Ai me këtë rast ftoi anëtarët e komisionit për vizitë pune në Akademi për t'u njohur nga afër me aktivitetet dhe veprimtarinë e saj.

Ismajl Kurteshi shtroi çështjen se sa i kushton rëndësi Akademia botimit të publikimeve të veta në gjuhë të huaj, mbi 50 për qind e publikimeve janë ribotime, sa është e saktë kjo informatë, revistën e vetme që Akademia e ka nxjerrë në gjuhën angleze nuk botohet që nga viti 1990, pse nuk botohet kjo revistë? Çështje tjetër e ngritur është edhe kodet ndërkombëtare të revistave, Kërkimi, Studimi dhe Studime Shoqërore. Ai ngriti çështjen e përqindjes së buxhetit që shpenzohet në projektet e Akademisë, më tej tha se nga 4 projektet e mëdha të Akademisë janë përfunduar vetëm dy, a ka ndikim politika në punën e Akademisë, dhe sa është ai ndikim, a keni trajtuar këto raste dhe nëse i keni trajtuar, cili është përfundimi i Akademisë, cili është bashkëpunimi i Akademisë së Kosovës ma atë të Shqipërisë dhe a ka ndonjë projekt konkret si dhe ngriti çështjen e plagjiaturës në punimet e disa nga anëtarët e Akademisë.

Teuta Haxhiu, tha se jemi shqetësuar bazuar në gjetjet e hulumtimit të organizatës Integra për punën e Akademisë, lidhur me plagjiaturën, projekte të pa përfunduara nga viti 2016 etj. Ajo

ngriti çështjen e rezultateve me interes për vendin nga projektet e Akademisë lidhur me temat me interes për vendin, si dhe rezultatet konkrete nga bashkëpunimi me akademitë e tjera, si dhe me Universitetet publike në vend. Ajo ngriti edhe çështjen e një kërkese të Universitetit të Prishtinës drejtuar Akademisë për shfrytëzimin e hapësirave në objektin e Akademisë të cilat janë të pashfrytëzuara.

Driton Çausi ngriti çështjen e gjetjeve nga hulumtimi i realizuar nga organizata Integra, ku nga 22 anëtarë të Akademisë të rregullt vetëm 3 nga ta kanë publikime në revistat shkencore të huaja dhe kjo është shqetësuese. Çështje tjetër është shqetësuese aktiviteti i akademisë sonë me akademitë e tjera, me sa kemi informacione nuk ka ndonjë projekt serioz hulumtues shkencor që është duke vazhduar mes akademisë sonë dhe akademive të tjera. Çështje tjetër përmendi edhe procesin e përzgjedhjen së anëtarëve të akademisë, si dhe kriterëve për pranimin e tyre. Tutje tha se kam njohuri se në konkursin e fundit për anëtarët e rinj të Akademisë ka kandidatë që kanë kandiduar me dhjetëra publikime shkencore, ndërsa janë pranuar të tjerët që nuk kanë pasur publikime, me këtë rast kërkon sqarim se a ka zyre për ankesa në Akademi për raste të tilla. Pyetja tjetër ishte se a ka strategji brenda akademisë se cilat janë prioritetet për katër fushat themelore nëse janë të përfaqësuara mirë, sepse nga jashtë shihet se ka fusha të mbi përfaqësuara dhe fusha tjera që nuk janë mirë të përfaqësuara. Çështje tjetër që ngriti kishin të bënin me realizimin e qëllimeve sipas ligjit, akuzat për plagjiaturë, si dhe shpenzimi i buxhetit.

Arbërie Nagavci kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e akademisë lidhur me realizimin apo rezultatet nga tre projektet e fundit që janë realizuar nga Akademia dhe konsiderohen me interes për zhvillimin e vendit nga që ky është edhe një obligim ligjor. Çështje tjetër përmendi edhe kujdesin për krijimin e kuadrove të reja, si dhe çështjen e hulumtimeve shkencore se çfarë është bërë deri me tani. Si çështje tjetër përmendi debatin publik lidhur me publikimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës me këtë rast sa është bashkëpunim me Akademinë e Shqipërisë dhe pse nuk është bërë një fjalor i përbashkët, si dhe cilat kanë qenë kriteret për përzgjedhjen e zërave dhe ngjarjeve për këtë fjalor?

Valentina Bunjaku-Rexhepi tha se çështjet e ngritura nga hulumtimi i një organizate të caktuar dhe kritikën për punën e akademisë do të duhej që të demantoheshin apo sqaroheshin nga vetë Akademia. Ajo kërkoi sqarim lidhur me kriteret që janë përdorë për projektin e fjalorit enciklopedik dhe bashkëpunimin e Akademisë me Universitetet publike.

Albulena Balaj-Halimaj kërkoi sqarim lidhur me qasjen e organizatës së caktuar në raport me Akademinë, a ka pasur diçka personale apo çfarë është në pyetje. Sa i përket buxhetit të akademisë mendon se nuk duhet pritur mrekulli në projekte shkencore nga se i njëjti nuk premton projekte të mëdha.

Arsim Bajrami, sa i përket çështjeve të ngritura rreth politizimit të akademisë, tha se çështja e politizimit është e rregulluar me ligj dhe nuk ka politizim në Akademi. Sipas tij, Akademia, mund të japë përgjigje vetëm në rast të ndonjë kërkesë institucionale lidhur me çështjet politike në vend, ashtu siç e kanë bërë edhe kur është hartuar Kushtetuta. Ai tha se pajtohet më atë që duhet të punohet më shumë që të ketë projekte zhvillimore dhe të konkurrojmë në fonde evropiane që janë fonde të destinuar për shkencë, me projekte nga fusha e zhvillimit ekonomik, nga fusha e inovacionit, teknologjive të informacionit, mjekësia dhe bujqësia. Në këtë drejtim do të hymë në partneritet me Akademitë evropiane. Tha se Akademia financohet nga buxheti i Kosovës, zbaton të gjitha vendimet e qeverisë dhe respektojmë të gjitha afatet ligjore që kërkohen zbatojmë rekomandimet e Zyrës së Auditorit edhe pse nuk kemi rekomandime serioze.

Mzyafere Limani, sa i përket raporti që i referohet komisioni, tha se e kemi pasur atë raport dhe ajo çka ka zgjuar kureshtjen, ka qenë kush qëndron mbas atyre dy organizatave joqeveritare. Duke marrë parasysh që financimi i tyre për ne është krejt i pa qartë, edhe hulumtimi i tyre është tejet i cekët. Akademia e ka për obligim t'i respektojë vlerësimet të cilat vijë prej institucioneve si motra, Akademia i merr gjithmonë seriozisht. Akademia i kushton rëndësi publikimeve në gjuhën e huaj, posaçërisht veprave të cilat pasqyrojnë Kosovën, i pasqyrojnë vetitë e Kosovës dhe të arriturat e Kosovës.

3. Të ndryshme

Në këtë pikët të rendit të ditës u diskutua lidhur me ftesën nga Komiteti i Parlamentit Evropian për Kulturë dhe Arsimin për pjesëmarrje e 4 (katër) anëtarëve të komisionit në takimin e komisioneve ndërparlamentare mbi "**Trashëgiminë Kulturore Evropiane**", që do të mbahet më 19-20 nëntor 2018 në Parlamentin Evropian në Bruksel.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që të enjten të mblidhet si grup punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi